



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	28.01.2020
Referencë/a	08 nr.5/2020
Për/Za/To :	Ramadan Sylejman Bytyqi nga Xërxa
Zona Kadastrale:	Xërxe
	Afrim Oruqi - Drejtor
Përmes/ Prekp/Through:	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Nga/Od/From/	Sektori për Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Vendim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë Inspektuese – Inspektori i Ndërtimtarisë 14 nr. 201 më datë: 21.01.2020, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë shtetërore, kundër të dyshuarit Ramadan Sylejman Bytyqi nga Xërxa, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“ Gazeta zyrtare e KASK ”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Ramadan S. Bytyqi nga Xërxa, ka zgjeruar kufirin e parcelës së vetë nr. 1808-0 në dëm të parcelës shtetërore nr. 1497-0, e cila evidentohet si P.Sh.e Kosovës K.K. Rahovec, me të cilën ka ndërtuar pjesën e murit rrethues në gjatësi prej 2.80 m, duke bërë uzurpim arbitrar të pasurisë shtetërore.

II. Uzurpuesi arbitrar Ramadan S. Bytyqi nga Xërxa, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj me mënjanimin e objektit të ndërtuara, të cekura në pikën I të këtij vendimi dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendim.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitin 2019.

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë me kërkesën 14 nr. 201 më datë 21.01.2020 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt inspektuese mbi ndërtimin e objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit përkatësisht në fshatin Xërxë, ka hasur tek Ramadan S. Bytyqi nga Xërxa ndërtimin e objektit të cekura në pikën I në dispozitivin e këtij vendimi, për çka dyshohet se ky ndërtim është bërë në parcelën komunale nr. 1497-0 dhe ka kërkuar nga kjo drejtori të vërtetohet gjendja faktike në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodetin e kësaj drejtorie kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 1497-0 dhe parcele private nr.1808-0, ka konstatuar se i përmenduri me veprimet që ka ndërmarr ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit, me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

I përmenduri me ftesë të kësaj drejtorie është paraqitur në zyrë të kësaj drejtorie ku ka dhënë deklaratë: Ku ka cekur se me qëllim, nuk ka bërë kurrfarë uzurpimi, por se nuk e ka ditur vijën kufitare të parcele së vet, dhe se nëse vërtetohet se kam bërë uzurpim arbitrar, unë do të rrënoj pjesën e murit të ndërtuar dhe se do të veproj komfor dispozitave ligjor në fuqi.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri, ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore ("Gazeta Zyrtare e KASK", 46/77 dhe 37/88), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.


U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës K.K. Rahovec, më datë 28 .01.2020

08 nr. 5/2020

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit përmes kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jur. i Diplomuar. Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jur. Diplomuar. Afrim Oruqi






Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec


Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu
Department of Cadastre




Skica e terrenit

Z,K, Xerxe

P/1:300



Me kërkesë të Drejtorisë për punë Inspektuese në Rahovec nr. 201 datë 21.01.2020 me datë 22.01.2020 kemi dalur në teren për ta bërë iqizimin e gjendjes faktike dhe kemi vërtetuar se Ramadan Sylejmon Bytyqi nga Xërxa me ndëtimin e murit me blloka të betonit në parcelen e vetë nr. 1808-0 është zgjeruar edhe në parcelen nr. 1497-0 në gjatësi prej: 2.80m që evidentohet në emer të P.Sh. K.K. Rahovec.



Rahovec me 27.01.2020

Miftar Krasniqi inxh